



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

15213
Nr. _____ prot.

Shkodër, më 20.10.2023

Lënda: **Kërkesë**

“Për emërimin e Drejtorit të Teatrit “Migjeni”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për miratim relacionin : *“Për emërimin e Drejtorit të Teatrit “Migjeni”*

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

Me Vendim Delegimi

ZV/KRYETAR

Onid BEJLEMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ prot.

Shkodër, më ____ . 2023

Relacion

“Për emërimin e Drejtorit të Teatrit “Migjeni”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i ndryshuar: neni 30, i ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe Kulturën” i ndryshuar: ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”. i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Rregullores nr. 96 prot, datë 20.03.2017 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër”; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 213 datë 28.07.2023 “Për miratimin e strukturës dhe listës emërore të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër, për vitin 2023”, shpalljes për pozicionin drejtor pranë Teatrit “Migjeni” me shkresë nr. 12029 dt. 29.08.2023 me lëndë “ Shpallje vende të lira pune Drejtor pranë Teatrit “Migjeni”, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër, Bashkia Shkodër në vijim të akteve ligjore të sipërcituara ka vijuar me shpalljen e pozicionit të lirë të drejtorit të Teatrit “Migjeni”.

Me vendim të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për verifikimin e dokumentacionit dhe juria për vlerësimin e platformës dhe intervistës me gojë.

Kandidatët të cilët në bazë të dokumentacionit janë kualifikuar kanë vijuar me konkurimin për fazën e intervistës me gojë dhe prezantimit të platformës së tyre. Me datë 25.09.2023, ora 17:00, pranë ambjenteve të Teatrit “Migjeni” është bërë nga secili kandidat prezantimi i platformës për menaxhimin e institucionit dhe intervistën me gojë.

Juria pasi bëri vlerësimin për secilin nga kandidatët pjesëmarrës i paraqiti 2 kandidatura më të mira konkretisht, znj. Sara Smajaj dhe z.Arian Çuliqi, titullarit për prezantim në Keshillin Bashkiak në bazë të neni 30, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe Kulturën” i ndryshuar ku theksohet *“Titullari i institucionit artistik e kulturor publik vendor emërohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe përzgjidhet ndërmjet dy kandidaturave të fushave të artit, të propozuara nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.”*

Nga sa më sipër kërkojmë nga ana juaj kalimin për votim të kandidaturave të propozuara për të emëruar drejtorin e Teatrit “Migjeni.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, Ju ftoj ta votoni kandidaturën më të mirë .

KRYETAR

Benet BECI

Me Vendim Delegimi
ZV/KRYETAR
Onid BEJLERI

